



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:044498

Datë: 02.12.2024

Numri i dokumentit: 06596516

KA.nr. 383/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Sharr Pllanina Vode” ShPK me NUI 810165979 dhe seli në fshatin Brod të Dragashit, të cilin në bazë të prokurës e përfaqëson N.Sh. me adresë në rrugën ... nr. 22/17 në Fushë Kosovës, kundër të paditurit Ministria e Infrastrukturës dhe Mjedisit me seli në Prishtinë, objekti i kontestit anulimi i aktit administrativ, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 08.10.2024, në të cilët mori pjesë përfaqësuesi i paditësit, ndërsa i padituri nuk mori pjesë, më 02.12.2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “Sharr Pllanina Vode” ShPK me NUI 810165979 kundër të paditurit Ministria e Infrastrukturës dhe Mjedisit, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit me numër 19/1760 të datës 25.02.2020 të së paditurit dhe kthimin e çështjes në rivendosje.

A R S Y E T I M

I. Padia, kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve

1. Paditësi më 17.04.2018 ka parashtruar padi kundër të Paditurit, me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit me numër 19/1760 të datës 25.02.2020 të së Paditurit dhe kthimin e çështjes në rivendosje.
2. Ai në padinë dhe gjatë seancës së shqyrtimit kryesor ka deklaruar se, vendimi është i kundërligjshëm sepse ai është nxjerr në mungesë të konstatimit të gjendjes faktike, ngase nuk i është dhënë mundësia që ta plotësoj lëndën dhe t'i ofroj sqarimet e nevojshme, ku e njëjta gjë edhe parashihet në bazë të nenit 13 dhe 131 të LPPA-së,

ngase që nga paraqitja e kërkesës në Drejtorinë e Urbanizimit në Dragash, ai i ka marr pëlqimet nga organi i shkallës së parë të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

3. Ka shtuar se, vendimi i goditur është mbështetur gabimisht në koordinatat të cilat i ka prezantuar ai, e sipas prezantimit-kërkesës së tij po të konstatohet gjendja e saktë faktike mbi koordinatat hapësinore, do të vinte në shprehje gjendje e re, e rrjedhimisht do të kishim edhe një konstatim të drejtë nga i Padituri, rrjedhimisht edhe raporti do të ishte pozitiv, që do të kishte pasur për pasoj lëshimin e lejes për pëlqim mjedisor. Sipas tij, në parcelat ku nuk e ka pronësinë, ai e ka të drejtën e shfrytëzimit në ato parcela.
4. Paditësi gjithashtu ka deklaruar se, vendimi i goditur gjithashtu është nxjerrë në kundërshtim me ligjin material, ngase në mungesë të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike, janë zbatuar gabimisht dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ligjit për Ndikimin Mjedisor, ngase në rastin e kundërt, po që se të konstatohej me kohë gjendja faktike e paraqitur sipas kërkesës së tij, edhe dispozitat të cilat lejojnë dhënien e pëlqimit apo lejes mjedisore do të aplikoheshin në pajtim me kërkesën e tij.
5. Paditësi gjithashtu ka argumentuar se, atij nuk i është dhënë të drejtën e ankesës në procedurë administrative në pajtim me nenin 13 të LPPA-së, ku përcaktohet parimi i palës në procedurë administrative që të mund të ushtrojë mjetet juridike të parapara me këtë ligj, që fillimisht t'i shtjerë këto mjete brenda organit administrativ, duke zbatuar nenin 131 të po të njëjtit ligj, ku parashihet procedura e shqyrtimit të ankesës nga ana e organit publik. Për më tepër, arsyetimi i vendimit të goditur nuk është i qartë sipas nenit 48 par. 1 të LPPA-së.
6. I padituri me përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi padinë, duke theksuar se vendimi i kontestuar është nxjerrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë, ndërsa Paditësi nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij me asnjë provë. Në seancat e shqyrtimit kryesor nuk ka marr pjesë fare, ndonëse ishte i ftuar në mënyrë të rregullt.

## II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

7. Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i aprovoi të gjitha propozimet e palëve për administrimin e prova. Në këtë drejtim, në seancën për shqyrtimin kryesor u administruan provat si në vijim: vendimi me numër të referencës 10/1760/MIA i datës 25.02.2020 i të paditurit; autorizimi i përgjithshëm LRP.nr.10609/2019 i datës 15.08.2019 i dhënë te noteri Sefedin Blakaj në Prishtinë;

kontrata mbi shitblerjen e tërësisë së aksioneve në Shoqërinë tregtare Sharr Pllanina Vode ShPK e lidhur ndërmjet A.C. dhe Real Estate Kosovo ShPK me datën 18.08.2020 te noteri Sefedin Blakaj, me shenjën nr. iLRP8041/2020; certifikata e regjistrimit me numër serik 10189744 e lëshuar nga ARBK më 27.09.2024 në emër të paditësit së bashku me informatat mbi biznesin, si dhe shkresat e lëndës të procedurës administrative të dorëzuara nga i padituri përmes përgjigjes në padi.

8. Gjykata pas analizimit të provat të cekura më lartë në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe duke i zbatuar rregullat e të provuarit nga neni 322 i LPK-së lidhur me nenin 43 dhe 63 të LKA-së e konstatoi gjendjen faktike të përshkruar më poshtë.
9. Me datë 29.03.2019 Paditësi ka paraqitur te i Padituri përmes formularit standard kërkesë për pëlqim mjedisor për hidrocentralin në fshatin Brod të Dragashit. Në atë formular ishin listuar dokumentet që duhet të dorëzohen së bashku me kërkesën. Së bashku me kërkesën, Paditësi e kishte paraqitur edhe raportin e vlerësimit në mjedis për ndërtimin e hidrocentraleve “Sharr Pllanina” 1 dhe 2 në lumin Davenicë dhe Brod në Dragaash. Këto fakte gjykata i vërtetoi përmes kërkesës me numër të protokollit 1760/19 të datës 29.03.2019 dhe raportit të sapo cekur, si pjesë e shkresave të lëndës administrative.
10. Më 31.10.2019 nga ora 11:00 ishte mbajtur debati publik lidhur me raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedise për ndërtimin e hidrocentraleve “Sharr Pllanina 1 dhe 2” sipas njoftimit përkatës të DMMU-së. Këtë fakt gjykata e konstatoi përmes procesverbalit për debat publik të datës 31.10.2019, si pjesë e shkresave të lëndës administrative.
11. I Padituri më 14.11.2019 kishte kërkuar nga Paditësi plotësimin e dokumentacionit, ashtu që kishte kërkuar që të dorëzohet (i) pëlqimi i komunës jo më i vjetër se gjashtë muaj për ndërtimin e hidrocentraleve në parcelat e synuara; (ii) kontratën për shfrytëzimin e ngastrave për rastet kur ngastrat nuk janë pronë e Paditësit, (iii) mendimin profesional të AMMK-së, cilës zonë të mbrojtur i takojnë ngastrat kadastrale mbi të cilat planifikohet ndërtimi i hidrocentralit. Lidhur me pikën e fundit i Padituri zyrtarisht kushte kërkuar informacione nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (këtu e tutje AMMK). Këto fakte gjykata i konstatoi përmes dokumentit “Plotësim i dokumentacionit” me referencës 19/170/2-259/DMMU të datës 14.11.2019 të lëshuar nga Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave (këtu e tutje DMMU), si pjesë e shkresave të dosjes administrative.

12. AMMK përmes përgjigjes 6898/19 të datës 16.12.2019 e kishte njoftuar Paditësin se lokacionet e planifikuara për hidrocentrale sipas koordinatave gjeografike të ofruara nga ai, ndodhën kryesisht brenda parkut kombëtar “Sharr”, gjegjësisht në Zonën e Parë, Dytë dhe fare pak në Zonën e Tretë të mbrojtur. Më tutje kishte konkretizuar se, 3,53km ose 42% e distancës së planifikuar ndodhet në Zonën e Parë, 3,49km ose 42% në Zonën e Dytë dhe vetëm 1,36km ose 16% planifikohet në Zonën e Tretë. Këto fakte gjykata i vërtetoi nga përgjigja e sapo cekur, si pjesë e shkresave të dosjes administrative.
13. I Padituri më 25.02.2020 e kishte dhënë vendimi nr. 19/176/ZSP/104/20 (19/1760/MIA), përmes të cilit e kishte refuzuar kërkesën e Paditësit për pëlqimin mjedisor për ndërtimin e hidrocentraleve “Sharr Pllanina 1 dhe 2”. Në vendim kishte arsyetuar se, në parkun kombëtar Sharri lejohen vetëm veprimtari hoteliere – turistike dhe rekreative, si dhe bujqësia ekstencive tradicionale, ndërsa ndalohet shfrytëzimi ekonomik i të mirave natyrore. Gjithashtu ka arsyetuar se, në parkun kombëtar Sharri, zona e parë gëzon mbrojtje strikte, në zonën e dytës mund të ushtrohet ekoturizëm, bujqësia tradicionale dhe veprimtaritë tjera që nuk janë në kundërshtim me qëllimet e mbrojtjes, ndërsa në zonën e tretë bëhet ndërtimi, rindërtimi, mbrojtja e objekteve tradicionale e rekreative, turizmi dhe nevojat e banorëve. Këto fakte gjykata i konstatoi përmes vendimit të goditur.
14. Gjykata gjithashtu konstatoi se Paditësi ishte i pajisur me pëlqim komunal për ndërtimin e mini hidrocentraleve. Këtë fakt gjykata e konstatoi përmes konfirmimit 01-060/01-27292/1 të datës 15.11.2019 të lëshuar nga Komuna e Dragashit, si pjesë e shkresave administrative.
15. Përveç kësaj, gjykata gjeti se parcela P-70604005-02109-1 në Dragash në momentin e aplikimit ishte pronë e D.S. VODE, ndërsa parcela P-70604005-01077-0 në Dragash në momentin e aplikimit ishte pronë e J.C. Këto fakte gjykata e konstatoi përmes certifikatave përkatëse për secilën parcelë, si pjesë e shkresave të lëndës administrative.
16. Provat tjera të administruara nga gjykata nuk provuar ndonjë fakt tjerët relevant lidhur me këtë çështje, prandaj gjykata vendosi të mos lëshohet në elaborimin e hollësishëm të tyre.

### III. Vlerësimi meritore i rastit

17. Gjykata pas i mori parasysh të gjitha pretendimet e ndërgjyqësve, gjendjen faktike të konstatuar, si dhe pas analizimit të dispozitave juridike të shqyrtuara më poshtë, erdhi në përfundim se kërkesëpatria e Paditësit është e pabazuar në ligj, ajo duhet të refuzohet.
18. Në rend të parë, gjykata gjen se procedura administrative që i ka paraprirë aktit administrativ të goditur është zbatuar në përputhje me LPPA-në. Gjithashtu, gjykata vë në pah se vendimi i goditur është i hartuar sipas nenit 47 dhe 48 të LPPA-së. Për më tepër, gjykata gjen se i Padituri është kompetent për zhvillimin e procedurës administrativ dhe nxjerrjen e vendimit të goditur.
19. Përveç kësaj, gjykata gjeti se i Padituri i ka konstatuar të gjitha faktet relevante lidhur me rastin, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë në kuptim të gjendjes faktike. Në këtë drejtim, gjykata rikujton se i Padituri e ka refuzuar kërkesën e Paditësi, pasi kishte konstatuar se (i) Paditësi nuk i ka dorëzuar kontratën për shfrytëzimin e ngastrave parcelave, që nuk ishin pronë e tij, (ii) lokacionet e planifikuara për hidrocentrale sipas koordinatave gjeografike të ofruara nga Paditësi, ndodhën kryesisht brenda parkut kombëtar “Sharr”, gjegjësisht në Zonën e Parë, Dytë dhe fare pak në Zonën e Tretë të mbrojtur, më konkretisht 3,53km ose 42% e distancës së planifikuar ndodhet në Zonën e Parë, 3,49km ose 42% në Zonën e Dytë dhe vetëm 1,36km ose 16% planifikohet në Zonën e Tretë (iii) në parkun kombëtar Sharri, zona e parë gëzon mbrojtje strikte, në zonën e dytës mund të ushtrohet ekoturizëm, bujqësia tradicionale dhe veprimtaritë tjera që nuk janë në kundërshtim me qëllimet e mbrojtjes, ndërsa në zonën e tretë bëhet ndërtimi, rindërtimi, mbrojtja e objekteve tradicionale e rekreative, turizmi dhe nevojat e banorëve. Në anën tjetër, Paditësi nuk ka sjellë asnjë provë, nga e cila do të rezultonte se gjendja faktike e konstatuar nga i Padituri është jo e saktë, gjegjësisht se e ka dorëzuar kontratën dhe hidrocentralet planifikohet në ndërkohën në zona tjera jashtë parkut kombëtar Sharri ose në zona të parkut kombëtar Sharri, në të cilat lejohet ndërtimi i objekteve të tilla. Gjykata rikujton se, sipas nenit 322 para. 2 të LPK-së, barra e të provuarit i takon Paditësit për të vërtetuar se konstatimet e të Padituri nuk kanë qenë të sakta, përderisa në shkresat e lëndës administrative nuk rrjedh diçka tjetër.
20. Përveç kësaj, gjykata gjen se i Padituri në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale administrative. Sipas nenit 29 të Ligjit mbi 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (këtu e tutje LMM) “1. Vlerësimi i ndikimit të projekteve në mjedis bëhet për projekte të cilat planifikohen të realizohen në hapësirë të caktuar, duke përfshirë edhe

*ndryshimet e teknologjisë, rekonstruimin, zgjerimin e kapaciteteve ose ndërprerjen e punës, gjë që mund të sjell deri te ndotja e mjedisit ose mund të paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut. 2. Vlerësimi i ndikimit në mjedis, përfshinë projektet nga lëmenj të industrisë, xehetarisë, energjetikës, komunikacionit, turizmit, bujqësisë, pylltarisë, ujërave dhe veprimtarive komunale, si dhe të gjitha projektet të cilat planifikohen në zonat e mbrojtura të natyrës dhe në rrethinën e mbrojtur të vlerës së paluajtshme të kulturës. 3. Vlerësimi i ndikimit të projekteve në mjedis është pjesë përbërëse e dokumentacionit teknik pa të cilin nuk mund të fillon zbatimi i projektit dhe kryhet në përputhje me procedurën sipas ligjit të veçantë”, kurse nenit 31 i po të njëjtit ligj ka rregulluar se “1. Lëshimi në punë i objektit të ndërtuar apo i stabilimenteve dhe pajisjeve që kanë qenë objekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis, nuk mund të filloj veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore. 2. Leja mjedisore lëshohet për periudhën pesë vjeçare, sipas procedurës së përcaktuar për pranim teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryerjes së punës provuese deri në gjashtë muaj, por gjithsesi para lëshimit në punë. 3. Ministria, me akt nënligjor, përcakton aktivitetet e nevojshme për lëshimin e lejes mjedisore, formën e aplikimit, përmbajtjen e lejes mjedisore, revokimin e lejes, vazhdimin e vlefshmërisë si dhe regjistrin e lejeve të lëshuara”. Nga këto dispozita kuptohet se, në rastin konkret para ndërtimit të hidrocentralit ka qenë i nevojshëm vlerësimi i ndikimit në mjedis, ndërsa pa pëlqimin mjedisor nuk ka mundësi që të vihet në funksion hidrocentrali.*

21. Në anën tjetër, neni 3 të Ligjit 04/L-087 për Parkun Kombëtar “Sharri” (këtu e tutje LPKSh) ka rregulluar se “1. Në territorin e Parkut kombëtar “Sharri” vendosen regjimet e mbrojtës sipas zonave: 1.1. Zona e parë - përfshinë pjesët e territorit të Parkut kombëtar “Sharri” me veçori natyrore të jashtëzakonshme, me lloje të rralla, të rrezikuara të bimëve dhe shtazëve dhe tipave të vendbanimeve në kushte të natyrës së egër. Kjo zonë gëzon karakterin e mbrojtjes strikte; 1.2. Zona e dytë - menaxhimi aktiv përfshinë pjesët e territorit të Parkut kombëtar “Sharri” që karakterizohen me ekosisteme, vlera peizazhore dhe vlera tjera të natyrës ku mund të ushtrohen ekoturizmi, bujqësia tradicionale dhe veprimtaritë të cilat nuk janë në kundërshtim me qëllimet e mbrojtjes; 1.3. Zona e tretë – e shfrytëzimit të qëndrueshëm përfshinë pjesët e territorit të Parkut kombëtar “Sharri” ku mund të bëhet: ndërtim, rindërtim, mbrojtje të objekteve tradicionale dhe rekreacion, turizëm dhe nevoja të banorëve në territorin e Parkut Kombëtar, si dhe shfrytëzim të kullosave dhe shfrytëzim ekonomik i të mirave

*të natyrës sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës si dhe në harmoni me ligjet përkatëse dhe Planin Hapësinor të Parkut Kombëtar. 1.4. Zona e ndikimit - përfshinë hapësirën prej pesëdhjetë (50) metra nga kufiri i Parkut kombëtar “Sharri” që shërben për parandalimin e ndikimeve të dëmshme në Parkun kombëtar. 2. Përcaktimi i regjimeve të mbrojtjes bëhet me Planin hapësinor të Parkut kombëtar “Sharri” ndërsa veprimtaritë dhe aktivitetet zhvillohen sipas Planit të menaxhimit të Parkut kombëtar dhe legjislacionit në fuqi”. Siç vërehet, këto dispozita e ndajnë parkun kombëtar Sharri në katër zona, për të cilat gjithashtu ka caktuar në mënyrë të përgjithshme aktivitetet dhe ndërhyrjet e mundshme në secilën zonë.*

22. Nga dispozitat e cituara më lartë rrjedh se, në zonat e mbrojtura ndërtimet mund të bëhet vetëm nëse paraprakisht ministria përkatëse jep pëlqimin mjedisor. Megjithatë, me LPKSh qartazi janë përcaktuar llojet e ndërhyrjeve në parkun kombëtar Sharri sipas zonës. Duke qenë se rreth 84% e projektit për ndërtimin e hidrocentralit përfshinte Zonën e Parë dhe të Dytë të parkut kombëtar Sharri, në të cilët me ligj nuk lejohet ndërtimi, atëherë për këtë gjykatë i Padituri në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale kur e ka refuzuar kërkesën e Paditësit për pëlqim mjedisor.
23. Gjykata e gjen të pabazuar pretendimin e Paditësi se nuk i është dhënë e drejta e ankesës. Me nenin 13 i LPPA-së ka paraparë se *“Përveç kur përjashtohet shprehimisht me ligj, secili person ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative dhe ato gjyqësore, në mënyrën e përcaktuar me ligj, kundër një veprimi apo mosveprimi administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë apo një interes juridik”*. Pra, e drejtë për ankesë është e garantuar, përveç nëse ndryshe është paraparë me ligj. Sipas nenit 128 [Ndërhyrjet në zonën e mbrojtur] të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës *“1. Në zonën e mbrojtur lejohen ato ndërhyrje dhe punë të cilat nuk i dëmtojnë dhe nuk i ndryshojnë veçoritë për shkak të cilave zona është shpallur e mbrojtur (...) 3. Lejen për ndërhyrjet dhe punët në rezervatin strikt, zonën e veçantë, parkun kombëtar, parkun e natyrës dhe monumentin e natyrës e lëshon Ministria”*. Nga këto dispozita rrjedh se, lejen për ndërhyrje dhe punë në parkun kombëtar e lëshon Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Duke u nisur nga ky fakt, gjykata vlerëson se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit nuk ka organ epror, i cili do të vendoste për ligjshmërinë e vendimeve të saj, rrjedhimisht në bazë të nenit 124 para. 6 nënpara. 1 të LPPA-së, Paditësi e ka gëzuar dhe shfrytëzuar mundësinë që t’i drejtohet gjykatës për mbrojtje gjyqësore. Gjykata e sheh të rëndësishme të sqaroj se, Ministria e Mjedisit dhe

Planifikimit Hapësinor që nga viti 2019 është bashkuar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe të dyja quhen Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, rrjedhimisht Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor tani janë një ministri.

24. Gjykata gjithashtu e vlerëson të pabazuar edhe pretendimin e Paditësit se atij nuk i është dhënë mundësia që të paraqes dokumente shtesë. Gjykata rikujton se në formularin për paraqitjen e kërkesë për pëlqim mjedisor kanë qenë të listuara dokumentet të cilat duhet të dorëzohen për të pajisur me atë pëlqim. Gjithashtu, gjykata vë në pah se i Padituri më 14.11.2019 i kishte kërkuar Paditësit plotësimin e dokumenteve, siç është sqaruar te pjesa e gjendjes faktike. Përveç kësaj, Paditësi gjatë gjithë procedurës nuk e ka pasur asnjë pengesë që të paraqes dokumente ose prova tjera shtesë, e as të propozoj prova me qëllim që t'i vërtetoj pretendimet e tij lidhur me kërkesën për pëlqim mjedisor. Për vlerësim të kësaj gjykate, kthimi i çështjes në rivlerësim të i Padituri me qëllim që të paraqiten dokumente të reja, juridikisht nuk është i mundshëm, meqenëse kjo do të nënkuptonte anulimin e një aktit administrativ të ligjshëm.
25. Prandaj, meqenëse i Padituri ka qenë kompetent për të nxjerr vendimin e goditur, procedura që i ka paraprirë nxjerrjes së aktit administrativ të goditur është zbatuar në tërësi sipas rregullave të procedurës administrative, duke qenë se i Padituri ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm për të gjitha çështjet relevante të rastit, duke marrë parasysh se i Padituri e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë të gjendjes faktike, siç është sqaruar edhe në pjesën e gjendjes faktike në këtë arsyetim, gjykata vjen në përfundim se nuk është plotësuar asnjë kusht ligjore nga LPPA dhe LKA për anulimin e aktit administrativ të goditur, rrjedhimisht e refuzoi kërkesëpadinë e Paditësit
26. Për arsyet e cekura më lartë, gjykata përfundimisht vlerëson se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, rrjedhimisht duhet të refuzohet. Prandaj duke u bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.383/22



Gjyqtari

---

Arben Toska

**UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES:** Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.